KUJTIMET PREKESE TE AMALIA DERADES. SANDRO KISHTE ZE HYJNOR SI CARUZO

Suplementi i së dielës te SHQIPTARJA.com

E-mail: rilindasi@gmail.com

RILINDASI

Viti III - Nr:9 E diel, 3 mars 2013 Kryeredaktore: Admirina PEÇI

Na ndiqni edhe online

WWW.SHQIPTARJA.COM

RREFIMI I NENES SE MOISIUT

“Im bir dhuronte gjysmën e rrogës, por e gënjenin”

NGA PJETER LOGORECI

Për Aleksandër Moisiun është folur, shkruar e debatuar shumë. Për shumë kohë ai ka qenë objekti kryesor i gazetave e revistave në fushën e artit skenik, ku komentet ishin të shumëllojshme. Pat kritika të ashpra, nganjëherë dhe fyerje, por pat edhe objektivitet, simpati e dashamirësi. Edhe miqtë e tij, kolegët apo drejtuesit e teatrove, përcollën shpesh në shtyp kujtime nga karriera e tij profesionale, aktiviteti si dhe jeta e tij private. Dëshiroj të sjell këtu disa fragmente kujtimesh, kritikash, vlerësime nga jehona e shfaqjeve dhe e lojës së tij aktoriale, të panjohura deri tashti për lëxuesin shqiptar, pra ccfarë të tjerët kanë shkruar dhe folur për Moisiun duke filluar nga nëna e tij Amalia de Rada.

Në revistën “Die Komödie” që botohej në Vjenë, ku trajtoheshin problemet e jetës teatrore, vendosja e kontakteve të aktorve dhe artistëve austriak me pjesën tjetër të botës, ku publikoheshin talentet e reja e po ashtu kritikat e ndryshme, në numrin e saj 35, të vitit 1921 u botua një intervistë me Amalia de Raden, nënën e aktorit me origjinë shqiptare, Aleksandër Moisiut. Gazetari e titullon këtë intervistë “Bei Moissis Mutter” (tek nëna e Moisiut). Mendoj se është interesante për lexuesin të njohë disa pjesë të kësaj interviste e po ashtu edhe shenimet personale të familjes që gjinden në arkiven e Teatrit Kombëtar Austriak, ku përfshihen edhe kujtimet e nënës, për mbretin e skenës Aleksandër Moisi. Autori e fillon shkrimin me fjalët e Franz Molnár (1):

Ccdo ditë mund të jetë një festë e vogël Krishtlindjeje..... Vetëm se ju nuk mund ta kuptoni. Ccdo ditë mundet që një grua e zgjedhur, të lindë atë që është...

vijon në faqen 14-15

NË FOTO: Aleksandër Moisiu me nënën e tij Amalia de Rada dhe Aleksandër Moisiun në të përjaveshmen artistike Komödie (Foto P.Logoreci)

Gaci, Qemali, Enveri... tre mësues të nderuar tre krijues të rrallë

Homazhe në kujtim të tre mësuesve të nderuar zëllezërve Draçini dhe krijuesit Gac Çuni. Me 6 mars – 91 vjetori i lindjes së Qemalit; viti 2013 – 57 vjetori i vdekjes së Gacit dhe 10 vjetori i vdekjes së Enverit...

NEXHMI BUSHATI

Dita e Mësuesit” po afron. Në kuadrin e veprimtarive që duhet e mund të zhvillohen, zënë vend dhe homazhet në nderim të mësuesve elitarë të shuar, nga radhët e të cilëve, për motivet që do të shtjellohen, kam zgjedhur tre emra të nderuar: Qemal Draçini(1922 – 1947), Gac Çuni (1925 – 1956)dhe Enver Draçini(1926-2003). Janë vendosur së bashku për dy lloj arsyesh: subjektive, Qemali - qe profesori im, Enveri – i vëllai, shoku dhe miku im më i ngushtë, Gaci – kantautori i ëmbël e me shpirt të lirë ; ato objektive do të shtjellohen në vijim. Me 6 mars – 91 vjetori i lindjes së Qemalit; viti 2013 – 57 vjetori i vdekjes së Gacit dhe 10 vjetori i vdekjes së Enverit, një vdekje e përjetuar së afërmi. Qasja e parë kryesore midis tyre : të tre qenë mësues, të tre mbajnë tituj tepër dinjitozë, atribuar pas rënies së komunizmit: dy të parët, “Martirë të Demokracisë”, Enveri, “Mësues i Popullit”. Qasje të tjera:dy të parët e patën të shkurtër jetën e mësuesisë, vetëm njëvjeçare; u arrestuan krye viti – Gaci më 1945, Qemali më 1946, që pas torturash çnjerëzore vdiq në duart e xhelatëve. Gacit nuk ia ndërprenë trajtimin mizor, por të gjallë e lanë për t’ia nxirë jetën burgjeve e kampeve dhe për ta lënë ta vdiste në Burgun e Burrelit pa i dhënë mjekim...

faqe 18-19

Shqipëria, poezia që i dhuroi çmimin e parë Elizabeth T. Gray,Jr

Njohja me znj Gray, Jr, një grua e gjithanshme, eksperte e negociimeve komplekse lidhur me ndërtimin e aleancave strategjike , përkthyese letërsie nga persishtja dhe gjuha e Tibetit dhe poete...

faqe 16-17

Luigi Nidito rrëfime për Shqipërinë e ’90-ës

Kontakti im me Maschito-n arbëreshe ka qenë gjithmonë i gjallë që nga fillimi i viteve ’90, kur falë meje dhe mikut Michele, një delegacion funksionarësh shqiptarë vizitoi qendrat arbëreshe...

Në Bibliotekën Bashkiake të Maschito-s janë prezantuar disa libra të Luigi Nidito, një arbëresh nga Maschito që punon në Tiranë si zv/president dhe arkëtar i Dhomës së Tregtisë Italiane në Shqipëri. Themelues, së bashku me Michele Sciarillo, i qarkut arbëresh “Takim”, pikë referimi i arbëreshëve në të gjithë zonën e Firenze-Prato-Pistoia, që frekuentohet nga 4000 shqiptarë, Nidito nuk harron kurrë Maschito-n e tij dhe për këtë ka krijuar një broshurë me titullin domethënës: “Maschito, shtegu i kujtimeve”, në të cilën vë në pah Maschito-n arbëreshe, kontaktin me Shqipërinë dhe impenjimin e tij për të ardhmen. “Prej kohësh ka ndryshuar rezidencë nga Prato në Tiranë - ka deklaruar - por mbaj gjithmonë në zemër Maschito-n ku kam kaluar vite të tëra të jetës sime. Një Maschito që përshkohej nga kafshë të ngarkuara, plot me gra që, duke ardhur nga burimet e ujit, i mbanin fuçitë mbi kokë ose në një krah. Në vitet e para ’90, së bashku me Michele Sciarillo, u nisa për të organizuar në Shqipëri, në Tiranë, shkëmbime me Italinë. Kisha themeluar në Prato një dhomë të vogël tregtie itali-shqiptare, që mburrej për vizitën në Shqipëri së bashku me disa sipërmarrës pratezë, kur ende nën regjimin komunist nisën lëvizjet e para për të kërkuar liri me...

faqe 20

TE TJERËT | PËR MOISIUN

NË FOTO: (*Majtas*) Aleksandër Moisiun në të përjaveshmen artistike Komödie (Foto P.Logoreci) (*Djathtas*) Shkrimi "Te nena e Moisiut" në të përjavëshmen "Komödie" (Foto P.Logoreci)

NË FOTO: (*Lart*) Aleksandër Moisiu me nënën e tij Amalia de Rada (*Majtas*)

AMALIA DE RADA

Ju rrëfej tim bir Aleksandër Moisiun...

Sandro fal gjysmën e rrogës, është më i miri mes milionave, por shumë njerëz e gënjejnë.... ju nuk e dini sa vuan ai per personazhet që luan....

NGA PJETER LOGORECI

vijon nga faqja 13

..."i shumëprituri".... Që ta sjellë për ju, shumë orë e ditë mbi tokë.... Edhe kur Moissiu u lind, askush nuk e kuptoj që ishte një Krishtlindje e vogël...

Autori vazhdon: Mund të duket qesharake apo fëmijrore, por sa unë shkela te pragu i shtëpisë për të takuar zonjën Moisi, në një shtëpi plot dritë e mikpritëse, hoqa këpucët (me qëllim të mirë) dhe pata një ndjenjë mbrenda vehtes: ....ja.. toka e shenjtë...

Këtu nënë Amalia jeton me vajzat e saj, të cilat e rrethojnë atë me dashuri e kujdes. Kjo grua e pastër dhe e fortë në karakter, mban në muret e dhomave të dritëshme të shtëpisë, me qindra foto të djalit të saj TE MADH.... Në mëndyrë të pandërprerë, si frymëmarrja apo rrahjet e zëmres, të shoqëron në këtë ambient një ndjenjë mirësie e ngazëllimi nga prezenca e kësaj zoje e amvise shtëpie. Nëpërmes toneve të zhurmave dhe bisedave ditore, duket se kumbon në kujtimin e saj në çdo minutë, ai tingull i këndshëm i një zëri që është i veçantë dhe i papërsëritshëm, ai i Aleksandrit. Me sy të mbyllur apo të hapur ajo arrin të perceptojë vetëm një figurë. Mendimet e saj sillen pa pushim në një rreth, e mbajnë një emër: Alessandro. Ditë e natë digjen për te qirinjtë, në altarin e dashurisë prindore.

Sandroja është më i miri, asnjeri tjetër (..në mes miliona njerëzve..) nuk është kaq i mirë si ai. Nuk flas më tepër mbasi ai është djali im. Të gjithë ato që e njohin e dijnë këtë.... gjysmën e rrogës që merr ai e dhuron...

Për nënën Amalia de Rada, Aleksandri si më i vogli ndër fëmijë ishte i përzgjedhuri i saj. Ajo e thërriste atë Sandro..

Në çdo jetë njerëzore ndodhin gjëra të trishtuara, apo jo? – bisedon ajo me intervistuesin, por unë nuk duhet të ankohem për çka kam pasur në jetë. Ju nuk mund të përfytyroni sa i mirë është Alessandro. Ai perpiqet të ndihmojë të gjithë, ai dhuron shumë, edhe aty ku nuk njeh....

Sandroja është më i miri, asnjeri tjetër (..në mes miliona njerëzve..) nuk është kaq i mirë si ai. Nuk flas më tepër mbasi ai është djali im. Të gjithë ato që e njohin e dijnë këtë.... gjysmën e rrogës që merr ai e dhuron... çdo njeri që i vjen, ai e degjon me vemendje dhe i jep... i jep sa mundet me vehte. Kurr nuk e dëgjon të flasë apo të mburret për ato që jep...sikur ai vetë të ishte milioner.. Shumë nga ato që vijnë e genjejnë: njëri paraqitet si një piktor i rënë në fatkeqësi, një tjetër tregon një "fatkeqësi" tjetër, gjëra që nuk janë aspak të vërteta. Ai beson dhe dishron cdo të mirë për njerzit. Kur ndokush i tregon diçka të keqe, ai mundohet ta ngushëllojë duke i thënë: .... mos e beso këtë të lutem, kjo nuk mund të jetë e vërtetë, kjo është e gjitha një trillim... Ai dhuron shumë, më tepër seç duhet.... por ai duhet të mendojë edhe për të ardhmen e jetës së tij...ai ka një zemër të dhimbëshme e kjo nganjëherë më frikëson.

Dëshira e tij është që ti bëjë të gjithë njerzit të kënaqur e të gëzuar.. Qysh fëmijë ishte kështu, ka patur gjithmonë një shpirt të dhimbsur. Më kujtohet që kur shikonte ndonjë të rritur duke keqtrajtuar një kafshë, ai reagonte menjëherë duke e dënuar gjestin.... çdo krijesë e uronte dhe e bekonte

> Sandroja është më i miri, asnjeri tjetër (..në mes miliona njerëzve..) nuk është kaq i mirë si ai. Nuk flas më tepër mbasi ai është djali im. Të gjithë ato që e njohin e dijnë këtë.... gjysmën e rrogës që merr ai e dhuron...



NË FOTO: (*Lart*) Letër që Aleksandër Moisiu i dergon nënës së tij, gjatë turneut të tij jashtë vendit. (Foto P.Logoreci) (*Majtas*) Dokumenta arkivore për jetën e aktivitetin e Aleksandër Moisiut në Vjenë. (Foto P.Logoreci)

NË FOTO: Letrat origjinale të Moisiut në arkivën e Teatrit në Vjenë (Foto P.Logoreci)

Nëna e Moisiut: I thoja njoh vetëm dy zëra hyjnor ty dhe Caruzon....

...një herë kaloi nëpërmes Stadtpark- ut duke provuar me gjithë shpirt e ndjenja të zjarrta monologun e Hamletit. I rrembyer nga atmosfera e rolit që përjetonte, nuk kuptoj që njerzit filluan ti shkonin pas ...një ...dy ...pastaj një grup...në fund të pjesës, kur i pa, filloi të skuqej e të turpërohej.....

Alessandron. Ishte për tu habitur që ai nuk e vuante personalisht varfërinë që ne përjetonim....Dikur ne ishim e pasur. Burri im ishte tregëtare i njohur në Trieste. Çdo ditë shkonin dhe vinin nga porti anije të ngarkuara me mallrat e tij. Alessandro ishte edhe femijë i bukur. Të gjithë e donin. Talentin e tij e tregoj shumë heret, qysh i ri duke recituar pjesë nga Shakespeare .... dhe ne menduam që talenti i tij ishte në zërin e tij të kumbueshëm, prandaj e dergova qysh 16 vjec në Konservatorin e Vjenës. Po ai kishte një zë të mrekullueshëm. Kësaj i qëndroj edhe sot. Kur i them që unë njoh vetëm dy zëra hyjnorë – ti e Caruso, ai tallet me mua dhe ja tregon këtë episod të gjithë të njohurve tonë.....unë dhe

Kur ishte i ri dhe ju dha mundësia të luante rolin e Hamletit, e provonte rolin në shtëpi, me shumë këmbëngulje e pasion, saqë nganjëherë nga furia e lëvizjeve përplasej në muret e dhomës, që ishte shumë e vogël....

Caruso...dhe qesh me gjithë zemër. Por unë ju siguroj ju, që po degjuat djalin tim duke kënduar një këngë italiane, do të kënaqeni shumë, megjithëse me papjekurinë e rinisë ai e ka dëmtuar mjaft atë (zërin). Pat një kohë që ai këndonte gjithë ditën me zë të lartë. Ne e ndigjonim me kënaqësi, pastaj i tërhiqnim vëmendjen që të ruante zërin, por pa sukses. Ai ndoshta do të ishte sot një këngëtar i madh. Unë zotëroj një gramafon dhe shumë pllaka ku djali im ka folur dhe kenduar, po ashtu edhe të Carusos. Kur Alessandro udhëton larg, ky gramafon është argëtimi im. Për të gjithë familjen tonë Caruso është shumë i dashur, ai është një shok i mirë i djalit tim qysh kur u njohën bashkë në Paris. Na ka ardhur keq që Caruso vdiq i ri, ai ishte për ne si një pjestar i familjes.

NË FOTO: Kthimi i Moisiut në Zvicër nga burgu i Toulous - ës në Francë

Sa isha akoma e zonja të udhëtoj, shkoja me tim bir kudo dhe e kam parë duke luajtur në skenat e Berlinit e të Mynihut. Eshtë një fat dhe nder i madh për mua të shoh se si njerzit e duartrokasin, e duan dhe e nderojnë atë. E kam parë atë pothuajse në të gjithë rolet deri tani, por tek Fausti akoma jo e po pres me padurim javën tjetër ta shoh në këtë rol. Askush nuk di më mirë se unë se si ai ndjehet kur luan në skenë. Zemra e tij vajton me të vertetë se bashku me rolin, prandaj ai depërton në shpirtërat e njerzve që e shikojnë dhe i bën të lotojnë. Mbas shfaqjes ai vjen në garderobë i lodhur, i cfilitur, krejt i pafuqishëm sikur ai vetë të kishte përjetuar fatin e personazhit të tij.

Në dokumentet e familjes që gjinden në arkivë me mbishkrimin – "WAS DIE FAMILIE SAGT" (Cfarë thotë familja), nënë Amalia kujton të birin me këto fjalë:

Qysh fëmijë ka pasë deshirë të luaj teatër, ndante gjysmën e dhomës me perdet e shtëpisë dhe fillonte të këndonte dhe të bënte Othellon. Më pas dilte të mblidhte nga 2 Kreuzer....Kur ishte i ri dhe ju dha mundësia të luante rolin e Hamletit, e provonte rolin në shtëpi, me shumë këmbëngulje e pasion, saqë nganjëherë nga furia e lëvizjeve përplasej në muret e dhomës, që ishte shumë e vogël.... bile një herë kaloi nëpërmes Stadtpark- ut (parkut të qytetit) duke provuar me gjithë shpirt e ndjenja të zjarrta monologun e Hamletit. I rrembyer nga atmosfera e rolit që përjetonte, nuk kuptoj që njerzit filluan ti shkonin pas ...një ...dy ...pastaj një grup...në fund të pjesës, kur i pa, filloi të skuqej e të turpërohej.....

Amalia tregon se u zemërua shumë me te kur ai shkoj vullnetar në front të luftës në Francë, bile i shkruajti atij disa letra "të forta" ku e shante me fjalën "Du Boche" (fjalë që francezët e përdornin për të fyer krenarine e ushtarëve gjerman) ...kur të kthehesh do flasim bashkë..., por kur ai u kthye mbas një periudhe burgu dhe spitali, si gjithmonë i qeshur, ajo nuk tha asgjë, por vetëm qante nga gëzimi së bashku me te...

Në shkrimet e tjera që do të vijnë më pas, kam rezervuar për lexuesin shqiptare kujtimet e motrave të Aleksandrit, gruas së tij aktores Johanna Terwin, si dhe të miqve të tij Stefan Cvajg, Franz Kafka, Luigji Pirandelo....

SHENIME:

(1)Franz Molnár: Shkrimtar dhe publicist hungarez (1878 – 1952)